

**VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHËSHME TË ORTAKËVE
TË SHOQËRISË "SMART CONSTRUCTION INVEST"sh.p.k**

" SMART CONSTRUCTION INVEST "sh.p.k

është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar shqiptare, themeluar në datë, 29/09/2021, regjistruar në mënyrë të rregullt në Qendrën Kombëtare të Biznesit ("QKB"), me Numer Unik Identifikimi të Subjektit NUIS M12129013M, ("Shoqëria").

Vendi i Mbledhjes: Mbledhja është bërë në selinë e shoqërisë "SMART CONSTRUCTION INVEST " sh.p.k me adresë: Rruga "Qemal Stafa", pallati 25, hyrja 4, apartamenti 4, perballe Qendres Lincoln, Njesia Bashkiake nr.8 Tirane.

Data e Mbledhjes: 11.08.2025

Nr i vendimit 2

Ortakët e Shoqërisë prezent në mbledhje janë si më poshtë :

1. Z. Redi Struga zotërues i 100 % të kapitalit të shoqërisë;

Rendi i Dites

1. Miratimin e rritjes së kapitalit të Shoqërisë me ane të fitimit të 2024 të për shumën 59,900,000 leke (pesëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind mijë) lekë.Miratimin e vlerave te reja te kuotave të sejcilit Ortakë
2. Miratimin e raportit të rritjes së kapitalit të Audituesit Ligjor I.L.D-99 AUDIT sh.p.k;
3. Të ndryshme

DUKE QËNË SE :

" SMART CONSTRUCTION INVEST "sh.p.k është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar shqiptare, themeluar në datë, 29/09/2021, regjistruar në mënyrë të rregullt në Qendrën Kombëtare të Biznesit ("QKB"), me Numer Unik Identifikimi të Subjektit NUIS M12129013M, ("Shoqëria").

Shoqeria me aktivitetin e saj ka investuar dhe po investon per zgjerimin e kapaciteteve dhe zgjerimin e aktivitetit ekonomik.

Gjate vitit ushtrimor 2024 shoqeria ka pergatitur pasqyrat financiare dhe ka fitime te vitit ushtrimor 103,839,703 lekë dhe te humbje të mbartura ne shumen (41,811,782) leke. Para fillimit te rritjes se kapitalit shoqeria ka nje kapital te rregjistruar ne QKB prej 100,000 leke i ndare ne 1 kuotë për 1 ortak.

Ortakët e shoqërisë kanë vendosur që nga fitimi i 2024 me shumën 41,811,782 leke nga të mbulojë humbjet e mbartura dhe me vlerën 59,900,000 lekë të rris kapitalin e shoqërisë.

Te gjitha kërkesat për mbajtjen e një mbledhje të rregullt janë përmbushur në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe Ligjin Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.

PER SA ME SIPER, Asambleja e Ortakeve të shoqërisë SMART CONSTRUCTION INVEST” sh.p.k

VENDOSI :

1. Te miratojnë rritjen e kapitalit të shoqërisë me fitimet e vitit 2024 me shumën 59,900,000 leke.

Kapitali i shoqërisë nga 100,000 lekë, rritet edhe me 59,900,000 leke (pesëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind mijë) lekë dhe bëhet 60,000,000 leke (gjashtëdhjetë milion) lekë.

Kapitali mbas rritjes është i ndarë në 1 pjesë, si më poshtë :

Ortaku	Nr. i kuotave	Vlera e secilës kuotë mbas rritjes së kapitalit	Përqindja mbas rritjes së kapitalit
Redi Struga	1	60,000,000	100 %
Shuma	1	60,000,000	100%

2. Te miratojnë raportin e zmadhimit të kapitalit të hartuar nga Audituesi Ligjor shoqëria I.L.D-99 AUDIT sh.p.k.
3. Asnjë vendim tjetër nuk u morr në këtë mbledhje të Përgjithëshme të Asamblese së Ortakeve të Shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve të shoqërisë “ SMART CONSTRUCTION INVEST ” sh.p.k

Redi Struga

Redi Struga

